



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 155

Tiranë – E premte, 18 nëntor 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13872, datë 17.11.2022	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	18801
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 16.11.2022	Për miratimin e rregullit teknik “Për enët e thjeshta nën presion” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara.....	18802
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 31, datë 15.11.2022	Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.....	18823
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 305, datë 15.11.2022	Për delegim të përkohshëm kompetencash.....	18824
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 779, datë 10.11.2022	Për delegim kompetencash.....	18824
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 780, datë 10.11.2022	Për delegim kompetence.....	18825

**DEKRET****Nr. 13872, datë 17.11.2022****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 13, nenit 14, nenit 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Lajz Stefan Çapaliku
2. Alma Tasi Dutzi (Mitrushi)
3. Kamela Armand Brahimaj
4. Paula Ylli Ciko
5. Liam Björn Taulant Çaçellari
6. Jetmira Muhamet Logja (Stela)
7. Arben Çerçiz Topi
8. Eliodor Bashkim Kamberi
9. Stela Enver Shehu
10. Glauk Eliodor Kamberi
11. Parid Todi Ndreka
12. Leonard Ylber Shtraza
13. Savo Rado Kontiq
14. Aida Vasil Weissenböck (Thanasi)
15. Albana Dhori Spirollari
16. Edion Dhionis Gjika
17. Sidorela Nderim Dunga
18. Ernest Ilia Pana
19. Manjola Safet Plaku
20. Iliana Ilia Pana
21. Haziz Mahmut Koka
22. Arlind Ryhan Haziz Koka
23. Ylli Haziz Koka
24. Emanuel Emiljano Alushani
25. Fatbardha Hasan Hoxha (Cenolli)
26. Selma Idris Delija-Röhm
27. Margarita Pandi Mara
28. Sokratis Iakovos Peidis
29. Lukas Iakovos Peidis
30. Dritan Kujtim Metushi
31. Natalia Dritan Metushi
32. Regina-Lidhia Dritan Metushi
33. Brikena Edi Demo

34. Lavdërim Halit Peposhi
35. Ina Llukan Doko
36. Violeta Feti Demo (Kararaj)
37. Ramiz Edi Demo
38. Bujana Xhemil Spahija
39. Alda Pavlin Pjetri
40. Daniela Zharko Matanoviç (Hajkoja)
41. Jonela Mehmet Limaj (Ypi)
42. Ismail Edmond Lamçja
43. Everton Hysen Çela
44. Glen Hamza Meti
45. Flogert Hysen Çela
46. Mehmet Balil Balili
47. Alisa Ali Agolli
48. Ina Besnik Gega
49. Oltion Xhevat Mustafa
50. Rudina Pllumb Cërriku
51. Ledian Avni Cërriku
52. Estrelia Avni Cërriku
53. Manola Shaqir Fatsis (Basha)
54. Celona Ismail Koxhaj (Lalaj)
55. Kristo Myslim Koxhaj
56. Donelio Kristo Koxhaj
57. Megi Bajram Ajrizaj
58. Gezim Bajram Ajrizaj
59. Geralda Asllan Gabrani
60. Emilio Vangjush Pano
61. Endrit Kamber Asllani
62. Harneta Bajram Gjoci
63. Krisel Nikolla Kote
64. Manushaqe Xhaferr Mücke (Mullahi)
65. Albisa Fatos Isak
66. Fation Hysenj Lufta
67. Diar Fation Lufta
68. Fabion Fation Lufta
69. Juxhin Jani Hila
70. Sonila Velo Shatraj
71. Visela Nasi Hazizi
72. Jora Ditmir Hazizi
73. Izabela Lorenc Kalluçi
74. Andoneta Bilbil Kalluçi (Brahimaj)
75. Angela Lorenc Kalluçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



VENDIM
Nr. 730, datë 16.11.2022

PËR MIRATIMIN E RREGULLIT
TEKNIK “PËR ENËT E THJESHTA NËN
PRESION” DHE PËRCAKTIMIN E
LISTËS SË STANDARDEVE TË
HARMONIZUARA¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për enët e thjeshta nën presion” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilave janë përfshirë në listën bashkëlidhur këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për prezumimin e konformitetit të enëve të thjeshta nën presion, me kërkesat thelbësore të objektivave të shëndetit dhe të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Çdo enë e vendosur në treg, para hyrjes në fuqi të këtij rregulli dhe në përputhje me vendimin nr. 1065, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Enët e thjeshta nën presion’ dhe përcaktimin e standardeve të harmonizuara”, nuk do të pengohet të bëhet e disponueshme në treg, pas hyrjes në fuqi të këtij rregulli. Certifikatat e lëshuara, në përputhje me vendimin nr. 1065, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, janë gjithashtu të vlefshme sipas këtij rregulli.

4. Vendimi nr. 1065, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullit teknik

‘Enët e thjeshta nën presion’ dhe përcaktimin e standardeve të harmonizuara”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

RREGULLI TEKNIK
“PËR ENËT E THJESHTA NËN PRESION”
DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË
STANDARDEVE TË HARMONIZUARA

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Fusha e zbatimit

1. Ky rregull teknik (këtu e në vijim referuar si “Rregulli”) do të zbatohet për enët e thjeshta nën presion të prodhuara në seri me karakteristikat e mëposhtme:

a) Enët e salduara, të destinuara për t’iu nënshtruar një presioni të brendshëm të matjes më të madhe se 0,5 bar, të përmbajnë ajër ose azot dhe të mos kenë qëllime ndezjeje.

b) Pjesët dhe bashkimet që ndihmojnë në fortësinë e enës duhet të prodhohen prej çeliqueve cilësore jo të lidhur (çelik i zakonshëm) ose prej aluminit të pastër (jo aliazh) ose aliazhe alumini të panënshtuara teknikës së trajtimit në nxehtësi.

c) Ena është e përbërë nga:

i. një pjesë cilindrike me seksion rrethor të mbyllur së brendshmi me funde konkave/të lugëta dhe/ose të sheshta që kanë të njëjtin aks rrotullimi me pjesën cilindrike.

ii. dy funde në formë konkave që kanë të njëjtin aks rrotullimi.

ç) Presioni maksimal i punës së enës nuk duhet të kalojë vlerën 30 bar dhe vlera e prodhimit të këtij presioni me volumen e enës ($PS \times V$) nuk duhet të kalojë vlerën 1000 bar.L.

d) Temperatura minimale e punës nuk duhet të jetë më e ulët se -50°C dhe temperatura maksimale e punës nuk duhet të jetë më e lartë se 300°C për enët prej çeliku dhe 100°C për enët prej alumini ose aliazhe alumini.

2. Ky Rregull nuk zbatohet, për:

¹Ky vendim është përafshuar pjesërisht me direktivën 2014/29/BE të Parlamentit të Këshillit Evropian, të datës 26 shkurt 2014, për harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare, në lidhje me vendosjen në treg të pajisjeve të thjeshta nën presion, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 96, datë 29 mars 2016, faqe 45–78.



a) enë të projektuara posaçërisht për përdorime bërthamore, shpërthimi i të cilave mund të shkaktojë përhapjen e radioaktivitetit;

b) enë të parashikuara vetëm për instalime në anije dhe avionë ose si shtytëse në to.

c) Fikësit e zjarrit.

Neni 2 Përkufizimet

Për qëllime të këtij Rregulli do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “Bërje e disponueshme në treg” është çdo furnizim me enë për shpërndarje ose përdorim në tregun e Republikës së Shqipërisë gjatë një veprimtarie tregtare, me ose pa pagesë.

b) “Vendosje në treg” nënkupton vënien në dispozicion për herë të parë të një ene në tregun e Republikës së Shqipërisë.

c) “Prodhues” është çdo person fizik ose juridik, i cili prodhon një enë nën presion ose projektin dhe prodhon një enë nën presion dhe e tregon atë nën emrin e tij ose të markës tregtare.

ç) “Përfaqësues i autorizuar” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, i cili ka akt përfaqësimi nga një prodhues për të vepruar në emër të tij për detyra specifike, për detyrimet e prodhuesit, që parashikohen në këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

d) “Importues” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, i cili vendos në tregun e Republikës së Shqipërisë një enë nga një vend i huaj.

dh) “Shpërndarës” është çdo person fizik ose juridik, i përfshirë në zinxhirin e furnizimit, përveç prodhuesit ose importuesit, i cili bën të disponueshme në treg një enë nën presion.

e) “Operator ekonomik” është prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar, importuesi ose shpërndarësi.

ë) “Specifikim teknik” është një dokument që përshkruan kërkesat teknike që duhet të përmbushë ena.

f) “Standard i harmonizuar shqiptar” është një standard shqiptar, i miratuar dhe i publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme të Standardizimit (DPS), i cili transponon një standard evropian të harmonizuar, në mbështetje të këtij Rregulli teknik, sipas listës së përcaktuar nga Këshilli i Ministrave,

me propozimin e ministrit përgjegjës dhe/ose me autoritetet e tjera të administratës qendrore dhe në bashkërendim me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit. Lista e standardeve të harmonizuara shqiptare ose çdo ndryshim i saj botohen në Fletoren Zyrtare.

g) “Akreditim” është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organin e vlerësimit të konformitetit, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit.

gj) “Organizëm kombëtar i akreditimit” është organi që kryen akreditimin me autoritetin e dhënë nga ligji, sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për akreditimin.

h) “Vlerësim i konformitetit” është procesi që provon, nëse janë plotësuar kërkesat themelore të këtij Rregulli, në lidhje me enët nën presion.

i) “Organ i vlerësimit të konformitetit” është një organ që kryen aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, duke përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin.

j) “Kthim i produktit” është çdo masë për kthimin mbrapsht të një ene, që është bërë ndërkohë e disponueshme të përdoruesi i fundit.

k) “Tërheqje” është çdo masë që synon parandalimin e vendosjes në treg të një ene në zinxhirin e furnizimit.

l) “Markimi CE” është markimi, me të cilin prodhuesi tregon se ena është në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kur ky legjislacion parashikon fiksimin e këtij markimi.

Neni 3 Bërja e disponueshme në treg dhe përdorimi

Enët e thjeshta nën presion bëhen të disponueshme në treg dhe futen në përdorim vetëm nëse plotësojnë kërkesat e këtij Rregulli, kur instalohen dhe mirëmbahen siç duhet dhe përdoren për qëllimet për të cilat synohen.



Neni 4

Kërkesat thelbësore

1. Enët duhet të plotësojnë kërkesat thelbësore të sigurisë të përcaktuara në shtojcën I të këtij Rregulli, kur vlera e produktit PS x V është më e madhe se 50 bar.L

2. Enët, në të cilat vlera e produktit PS x V është e barabartë me 50 bar.L ose më e vogël, duhet të projektohen dhe të prodhohen në përputhje me praktikën më të mira inxhinierike.

Neni 5

Lëvizja e lirë

Në territorin shqiptar nuk do të pengohet bërja e disponueshme në treg dhe vënia në shërbim e enëve që përmbushin kërkesat e këtij Rregulli.

KREU II

**DETYRIMET E OPERATORËVE
EKONOMIKË**

Neni 6

Detyrimet e prodhuesit

1. Kur vendosin në treg enët e tyre, në të cilat produkti PSxV kalon 50 bar.L, prodhuesit duhet të sigurojnë që ato janë projektuar dhe prodhuar, në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë të përcaktuara në shtojcën 1 të këtij Rregulli.

2. Kur vendosin në treg enët e tyre, në të cilat produkti PSxV është 50 bar.L ose më pak, prodhuesit sigurojnë që ato janë projektuar dhe prodhuar në përputhje me praktikën më të mira inxhinierike.

3. Për enët, në të cilat produkti PS x V kalon 50 bar.L, prodhuesit hartojnë dokumentacionin teknik të referuar në shtojcën II të këtij Rregulli dhe kryejnë procedurën përkatëse të vlerësimit të konformitetit të përmendur në nenin 13, të këtij Rregulli, ose e realizojnë atë.

4. Kur përputhshmëria e një ene, në të cilën produkti PSxV kalon 50 bar.L, me kërkesat e zbatueshme, është provuar me atë procedurë, prodhuesit hartojnë një deklaratë EU të konformitetit dhe vendosin markimin CE dhe mbishkrimet e parashikuara në pikën 1 të shtojcës III të këtij Rregulli.

5. Prodhuesit sigurojnë që enët në të cilat produkti PSxV është 50 bar.L ose më pak, mbajnë

mbishkrimet e përcaktuara në pikën 1, të shtojcës III, të këtij Rregulli.

6. Prodhuesit mbajnë dokumentacionin teknik dhe deklaratën EU të konformitetit për 10 vjet pasi ena të jetë vendosur në treg.

7. Prodhuesit sigurojnë se zbatohen procedurat që prodhimi në seri të mbetet në konformitet me këtë Rregull. Ndryshimet në projektimin ose karakteristikat e enëve dhe ndryshimet në standardet ose specifikimet e tjera teknike, në lidhje me të cilat është deklaruar konformiteti i një ene, do të merren në konsideratë në mënyrë të përshtatshme.

8. Kur vlerësohet e përshtatshme për sa u përket rreziqeve të paraqitura nga një enë, prodhuesit, për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e përdoruesve të fundit, kryejnë testimin e mostrave të enëve të bëra të disponueshme në treg, hetojnë dhe, nëse është e nevojshme, mbajnë një regjistrë të ankesave për enët jo në përputhje dhe enët e kthyer nga tregu, si dhe informojnë shpërndarësit për çdo monitorim të tillë.

9. Prodhuesit sigurojnë që enët që kanë vendosur në treg të kenë një identifikim tipi dhe serial ose partie, që lejon identifikimin e tyre.

10. Prodhuesit vendosin në enë emrin e tyre, emrin e regjistruar tregtar ose markën tregtare të regjistruar, si dhe adresën postare ku ata mund të kontaktohen. Adresa duhet të tregojë një pikë të vetme ku mund të kontaktohet prodhuesi. Të dhënat e kontaktit duhet të jenë në gjuhën shqipe ose në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesit e fundit dhe struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.

11. Prodhuesit duhet të sigurojnë që ena është e shoqëruar nga udhëzimet dhe informacionet e sigurisë të përmendura në pikën 2, të shtojcës III, të këtij Rregulli, në gjuhën shqipe ose në një gjuhë që kuptohet lehtësisht nga përdoruesit e fundit. Këto udhëzime dhe informacione sigurie, si dhe çdo etiketim, duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të lexueshme.

12. Prodhuesit që gjykojnë ose kanë arsye të besojnë se një enë që kanë vendosur në treg nuk është në përputhje me këtë Rregull, marrin menjëherë masat korrigjuese të nevojshme për ta sjellë atë enë në konformitet ose për ta tërhequr apo kthyer atë nga tregu, nëse është e përshtatshme. Gjithashtu, kur ena paraqet një rrezik, prodhuesit njoftojnë menjëherë strukturën



përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, duke dhënë të dhëna veçanërisht për mospërputhjen dhe çdo masë korrigjuese të marrë.

13. Prodhuesit, në bazë të një kërkesë të arsyetuar nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, sigurojnë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të treguar konformitetin e enës me këtë Rregull, në formë shkresore ose elektronike, në një gjuhë që është lehtësisht e kuptueshme nga kjo strukturë. Prodhuesit bashkëpunojnë me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, sipas kërkesës së saj, për çdo veprim të ndërmarrë për të eliminuar rreziqet që paraqesin enët që ata kanë vendosur në treg.

Neni 7

Detyrimet e përfaqësuesve të autorizuar

1. Një prodhues, me anë të një akti përfaqësimi, mund të emërojë një përfaqësues të autorizuar. Detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 6, të këtij Rregulli, si dhe detyrimi për të hartuar dokumentacionin teknik të përmendur në pikat 3, 4 dhe 5, të nenit 6, të këtij Rregulli, nuk do të jenë pjesë e aktit të përfaqësimit të përfaqësuesit të autorizuar.

2. Një përfaqësues i autorizuar kryen detyrat e përcaktuara në aktin e përfaqësimit të marrë nga prodhuesi. Akti i përfaqësimit i lejon përfaqësuesit të autorizuar të kryejë të paktën sa vijon:

a) të mbajë në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut deklaratën EU të konformitetit dhe dokumentacionin teknik për 10 vjet, pasi ena të jetë vendosur në treg;

b) sipas një kërkesë të arsyetuar nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, t'i sigurojë kësaj strukture të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të treguar konformitetin e një ene;

c) të bashkëpunojë me strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, me kërkesën e saj, për çdo veprim të ndërmarrë për të eliminuar rreziqet që paraqesin enët e përfshira në aktin e përfaqësimit të përfaqësuesit të autorizuar.

Neni 8

Detyrimet e importuesve

1. Importuesit duhet të vendosin në treg vetëm enë të cilat janë në përputhje me këtë Rregull dhe legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.

2. Para vendosjes në treg të një enë në të cilën produkti PS×V kalon 50 bar.L, importuesit sigurojnë, që:

a) procedura e duhur e vlerësimit të konformitetit të përmendur në nenin 13 të këtij Rregulli të jetë kryer nga prodhuesi;

b) prodhuesi të ketë hartuar dokumentacionin teknik, që ena të ketë markimin CE dhe mbishkrimet e parashikuara në pikën 1, të shtojcës III, të këtij Rregulli, dhe shoqërohet nga dokumentet e kërkuara; dhe

c) prodhuesi ka përmbyllur kërkesat e përcaktuara në pikat 9 dhe 10, të nenit 6, të këtij Rregulli.

3. Kur një importues gjykon ose ka arsye të besojë se një enë, në të cilën produkti PS×V tejkalon 50 bar.L, nuk është në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë të përcaktuara në shtojcën I të këtij Rregulli, ai nuk do ta vendosë enën në treg derisa ajo të jetë sjellë në përputhje me këtë Rregull. Gjithashtu, kur ena paraqet një rrezik, importuesi informon për këtë qëllim prodhuesin dhe strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut.

4. Para se të hedhë në treg një enë, në të cilën produkti PS×V është 50 bar.L ose më pak, importuesit sigurojnë që ai është projektuar dhe prodhuar në përputhje me praktikën më të mirë të projektimit në vend, mban mbishkrimet parashikuar në pikën 1.2, të shtojcës III, të këtij Rregulli, dhe që prodhuesi ka përmbyllur kërkesat e përcaktuara në pikat 9 dhe 10, të nenit 6, të këtij Rregulli.

5. Importuesit vendosin në enë emrin e tyre, emrin e regjistruar tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën postare në të cilën ata mund të kontaktohen ose, kur kjo nuk është e mundur, në një dokument që shoqëron enën. Detajet e kontaktit do të jenë në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesit e fundit dhe struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.

6. Importuesit sigurojnë që një enë shoqërohet nga udhëzimet dhe informacionet e sigurisë të përmendura në pikën 2, të shtojcës III, të këtij Rregulli, në gjuhën shqipe.



7. Importuesit sigurojnë që, ndërsa një enë në të cilën produkti PS×V kalon 50 bar.L është nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e ruajtjes ose të transportit të tij nuk rrezikojnë përputhshmërinë e tij me kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në shtojcën I të këtij Rregulli.

8. Kur vlerësohet e përshtatshme në lidhje me rreziqet e paraqitura nga një enë, importuesit, për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e përdoruesve të fundit, bëjnë testimin e mostrave të enëve të bëra të disponueshme në treg, hetojnë dhe, nëse është e nevojshme, mbajnë një regjistër të ankesave për enët jo në konformitet dhe enët e kthyer, si dhe informojnë shpërndarësit për çdo monitorim të tillë.

9. Importuesit që gjykojnë ose kanë arsye të besojnë se një enë që ata kanë vendosur në treg nuk është në përputhje me këtë Rregull, marrin menjëherë masat korrigjuese të nevojshme për ta sjellë atë enë në përputhje, për ta tërhequr apo kthyer atë, nëse është e përshtatshme. Gjithashtu, kur ena paraqet një rrezik, importuesit informojnë menjëherë për këtë qëllim strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, duke dhënë detaje, veçanërisht për mospërputhshmërinë dhe masat korrigjuese të marra.

10. Për enët, në të cilat produkti i PS×V kalon 50 bar.L, importuesit mbajnë një kopje të deklaratës EU të konformitetit në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut për 10 vjet pas vënies në treg të enës dhe sigurohen që dokumentacioni teknik të vihet në dispozicion të kësaj strukture, nëse kërkohet.

11. Importuesit, me kërkesë të arsyetuar nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, i sigurojnë asaj të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm, në formë shkresore ose elektronike, për të demonstruar përputhjen e një ene me këtë Rregull, në një gjuhë që mund të kuptohet lehtë nga ajo strukturë. Ata bashkëpunojnë me këtë strukturë, me kërkesë të saj, për çdo veprim të ndërmarre për të eliminuar rreziqet që paraqesin enët që ata kanë vendosur në treg.

Neni 9

Detyrimet e shpërndarësve

1. Kur vendosin në treg një enë, shpërndarësit do të veprojnë me kujdesin e duhur në lidhje me kërkesat e parashikuara nga ky Rregull.

2. Para se të vendosin në treg një enë, në të cilën produkti i PS×V kalon 50 bar.L, shpërndarësit:

a) verifikojnë që ena mban markimin CE dhe mbishkrimet e parashikuara në pikën 1, të shtojcës III, të këtij Rregulli;

b) sigurohen që shoqërohet nga dokumentet e kërkuara dhe nga udhëzimet e informacionet e sigurisë, të përmendura në pikën 2, të shtojcës III, të këtij Rregulli, në gjuhën shqipe; dhe

c) sigurohen që prodhuesi dhe importuesi kanë përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat 9 dhe 10, të nenit 6, dhe në pikën 4, të nenit 8, të këtij Rregulli, përkatësisht.

3. Kur një shpërndarës gjykon ose ka arsye të besojë se një enë, produkti PS×V i së cilës tejkalon 50 bar.L, nuk është në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në shtojcën I, të këtij Rregulli, ai nuk do ta bëjë të disponueshme në treg atë enë deri sa të jetë sjellë në përputhje me ato kërkesa. Gjithashtu, kur ena paraqet një rrezik, shpërndarësi informon prodhuesin ose importuesin për këtë qëllim, si dhe strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut.

4. Para se të vendosin në treg një enë, produkti PS×V i së cilës është 50 bar.L ose më pak, shpërndarësit verifikojnë, që:

a) ena mban mbishkrimet e parashikuara në pikën 1.2, të shtojcës III, të këtij Rregulli;

b) shoqërohet nga udhëzimet dhe informacionet e sigurisë referuar në pikën 2, të shtojcës III, të këtij Rregulli në gjuhën shqipe; dhe

c) prodhuesi dhe importuesi kanë përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat 9 dhe 10, të nenit 6, dhe në pikën 4, të nenit 8, përkatësisht.

5. Shpërndarësit sigurojnë që, ndërsa një enë, produkti PS×V i së cilës kalon 50 bar.L, është nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e ruajtjes ose transportit të tij nuk rrezikojnë përputhshmërinë e tij me kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në shtojcën I të këtij Rregulli.

6. Shpërndarësit, të cilët gjykojnë ose kanë arsye të besojnë se një enë, të cilën ata kanë bërë të disponueshme në treg, nuk është në përputhje me këtë Rregull, sigurohen që të marrin masat korrigjuese të nevojshme për ta sjellë atë enë në konformitet, për ta tërhequr ose kthyer atë, nëse është e përshtatshme. Gjithashtu, kur ena paraqet një rrezik, shpërndarësit informojnë menjëherë strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut duke



dhënë detaje, veçanërisht, për mospërputhjen dhe për çdo masë korrigjuese të ndërmarrë.

7. Shpërndarësit, në bazë të një kërkesë të arsyetuar nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, sigurojnë të gjitha informacionet dhe dokumentacionin, në formë shkresore ose elektronike, të nevojshme për të demonstruar përputhshmërinë e një ene. Ata duhet të bashkëpunojnë me strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, me kërkesë të saj, për çdo veprim të ndërmarrë për të eliminuar rreziqet që paraqesin enët që ata kanë bërë të disponueshme në treg.

Neni 10

Rastet kur detyrimet e prodhuesve zbatohen për importuesit e shpërndarësit

Një importues ose shpërndarës do të konsiderohet prodhues për qëllimet e këtij Rregulli dhe do t'u nënshtrohet detyrimeve të prodhuesit sipas nenit 6, të këtij Rregulli, kur ai vendos një enë në treg nën emrin ose markën e tij tregtare ose modifikon një enë të vendosur më parë në treg, në mënyrë të tillë që mund të preket përputhshmëria me këtë Rregull.

Neni 11

Identifikimi i operatorëve ekonomikë

1. Operatorët ekonomikë, sipas kërkesës, identifikojnë të struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut:

a) çdo operator ekonomik që i ka furnizuar ata me një enë;

b) çdo operator ekonomik të cilin ata e kanë furnizuar me një enë.

2. Operatorët ekonomikë duhet të jenë në gjendje të paraqesin informacionin e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, për 10 vjet pasi të jenë furnizuar me enë dhe për 10 vjet pasi të kenë furnizuar enën.

KREU III

KONFORMITETI I ENËVE KU PRODUKTI PS x V ËSHTË MË SHUMË SE 50 BAR.L

Neni 12

Prezumimi i konformitetit të enëve në të cilat produkti PS×V është më i madh se 50 bar.L

Enët, në të cilat produkti i PS×V është më i madh se 50 bar.L dhe të cilat janë në përputhje me standardet e harmonizuara ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë botuar në Fletoren Zyrtare, do të prezumohet se janë në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në shtojcën I, të këtij Rregulli, të mbuluara në ato standarde ose pjesë të tyre.

Neni 13

Procedurat e vlerësimit të konformitetit

1. Para prodhimit të tyre, enët, produkti PSxV i të cilave është më i madh se 50 bar.L, do t'i nënshtrohen shqyrtimit EU të tipit (Moduli B), i përcaktuar në pikën 1, të shtojcës II, të këtij Rregulli, si vijon:

a) Për enët e prodhuara në përputhje me standardet e harmonizuara të përmendura në nenin 12, me zgjedhjen e prodhuesit, në njërën nga dy mënyrat e mëposhtme:

i. vlerësimi i konformitetit për projektimin teknik të enës përmes ekzaminimit të dokumentacionit teknik dhe provave mbështetëse, pa ekzaminimin e mostrave (Moduli B – Lloji i modelit);

ii. vlerësimi i konformitetit për projektimin teknik të enës përmes ekzaminimit të dokumentacionit teknik dhe provave mbështetëse, plus ekzaminimin e prototipit të enës në tërësi, si përfaqësuese e prodhimit të parashikuar (Moduli B – Lloji i prodhimit).

b) Për enët që nuk prodhohen ose prodhohen pjesërisht, në përputhje me standardet e harmonizuara të përmendura në nenin 12, të këtij Rregulli, prodhuesi paraqet për ekzaminim një prototip të enës së plotë, përfaqësuese e prodhimit të parashikuar, dhe të dokumentacionit teknik e provat mbështetëse për ekzaminimin dhe vlerësimin e konformitetit të projektimit teknik të enës (Moduli B – Lloji i prodhimit).



2. Përpara se të vendosen në treg, enët do t'u nënshtrohen procedurave të mëposhtme të konformitetit:

a) Kur produkti i PS×V është më i madh se 3 000 bar.L, në përputhje me tipin e bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit plus testimin e enës së mbikëqyrur (Moduli C1) i përcaktuar në pikën 2, të shtojcës II, të këtij Rregulli;

b) Kur produkti i PS×V është më i vogël se 3 000 bar.L, por më i madh se 200 bar.L, sipas zgjedhjes së prodhuesit, në njërën nga sa vijon:

i. konformitetin me tipin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit plus testimin e mbikëqyrur të enës (Moduli C1) të përcaktuara në pikën 2, të shtojcës II, të këtij Rregulli;

ii. konformitetin me tipin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit, plus kontrollet e mbikëqyrura të enës në intervale të rastësishme (Moduli C2), të përcaktuara në pikën 3 të shtojcës II të këtij Rregulli;

c) Kur produkti i PS×V është më i vogël se 200 bar.L, por më i madh se 50 bar.L, sipas zgjedhjes së prodhuesit, në njërën nga sa vijon:

i. konformitetin me tipin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit plus testimin e mbikëqyrur të enës (Moduli C1), të përcaktuara në pikën 2, të shtojcës II, të këtij Rregulli;

ii. konformitetin me tipin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit (Moduli C), i përcaktuar në pikën 4, të shtojcës II, të këtij Rregulli.

3. Regjistrimet dhe korrespondenca lidhur me procedurën e vlerësimit të konformitetit, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, do të hartohen në gjuhën zyrtare të vendit ku organi i miratuar është i regjistruar ose në një gjuhë të pranuar nga ky i fundit.

Neni 14

Deklarata EU e konformitetit

1. Deklarata EU e konformitetit provon se është vërtetuar përmbushja e kërkesave thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në shtojcën I, të këtij Rregulli.

2. Deklarata EU e konformitetit i përmbahet strukturës së modelit të paraqitur në shtojcën IV të këtij Rregulli, përmban elementet e specifikuar në modulet përkatëse të përcaktuara në shtojcën II dhe përditësohet vazhdimisht. Ajo do të përkthehet në gjuhën shqipe.

3. Nëse një enë është objekt i zbatimit të më shumë se një akti ligjor apo nënligjor që kërkon hartimin e deklaratës EU të konformitetit, do të hartohet një deklaratë e vetme konformiteti. Kjo deklaratë do të përmbajë identifikimin e akteve të zbatuara, duke përfshirë referencat e botimit të tyre.

4. Me hartimin e deklaratës EU të konformitetit, prodhuesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e enës me kërkesat e përcaktuara në këtë Rregull.

Neni 15

Parimet e përgjithshme të markimit CE

Markimi CE u nënshtrohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 16

Rregullat dhe kushtet për markimin CE dhe vendosjen e mbishkrimeve

1. Markimi CE dhe mbishkrimet e dhëna në pikën 1, të shtojcës III, të këtij Rregulli, vendosen në formë të dukshme, lehtësisht të lexueshme dhe të paheqshme në enë ose në pllakën e saj që përmban të dhënat.

2. Markimi CE fiksohet përpara se ena të vendoset në treg.

3. Markimi CE shoqërohet nga numri i identifikimit të organit të miratuar, i përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit. Numri i identifikimit të këtij organi vendoset nga vetë ai ose duke ndjekur udhëzimet e tij, nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

4. Markimi CE dhe numri i identifikimit të organit të miratuar mund të shoqërohet edhe nga ndonjë shenjë tjetër që tregon se produkti paraqet rrezik ose është për përdorim të veçantë.

5. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut siguron aplikimin korrekt të regjimit që rregullon markimin CE dhe ndërmerr veprimet e duhura, në rast të përdorimit të papërshtatshëm të këtij markimi, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.



KREU IV

MIRATIMI I ORGANEVE TË VLERËSIMIT
TË KONFORMITETIT

Neni 17

Miratimi i organeve të vlerësimit të konformitetit

1. Procedura e miratimit të organeve të miratuara për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit të palëve të treta, sipas këtij Rregulli, është ajo e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

2. Në të gjitha parashikimet në vijim të këtij Rregulli, termi “organ i miratuar” nënkupton një organ të notifikuar evropian ose një organ të miratuar shqiptar, i cili është miratuar sipas pikës 1 të këtij neni, për çdo rast.

Neni 18

Autoriteti miratues

1. Ministri përgjegjës për tregtinë vepron si autoritet miratimi për organet e vlerësimit të konformitetit në kuptim të këtij Rregulli.

2. Ministri përgjegjës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, vepron si autoritet miratues, i ngarkuar me detyrë për realizimin e procedurave të nevojshme për vlerësimin dhe miratimin e organeve të vlerësimit të konformitetit dhe monitorimin e organeve të miratuara, përfshirë pajtueshmërinë me nenet 20 dhe 22, të këtij Rregulli.

Neni 19

Detyrimi i informimit për autoritetin miratues

Ministria përgjegjëse për tregtinë publikon në faqen zyrtare të internetit dhe mban të përditësuar listën e organeve të miratuara me numrat e tyre të identifikimit, fushat për të cilat janë miratuar, periudhën e vlefshmërisë dhe çdo ndryshim të tyre.

Neni 20

Kërkesat në lidhje me organin e miratuar

1. Për qëllim miratimi, një organ i vlerësimit të konformitetit, përveç kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut, duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara në pikat 2 deri në 5, të këtij neni.

2. Organi i vlerësimit të konformitetit duhet të jetë një palë e tretë e pavarur nga organizata ose ena që vlerëson. Një organ që i përket një shoqate biznesi ose një federate profesionale që përfaqëson ndërmarrjet e përfshira në projektimin, prodhimin, ofrimin, montimin, përdorimin ose mirëmbajtjen e enëve që ajo vlerëson, mund të konsiderohet si e pavarur nga ato, me kushtin që të demonstrohet pavarësia dhe mungesa e çdo konflikti të interesit.

3. Organi i vlerësimit të konformitetit duhet të jetë në gjendje të kryejë të gjitha detyrat e vlerësimit të konformitetit, të përcaktuara në pikën 3.2, të shtojcave I dhe II, të këtij Rregulli, dhe në lidhje me të cilin është miratuar, qofshin këto detyra të kryera nga vetë organi i vlerësimit të konformitetit ose në emër dhe nën përgjegjësinë e tij.

4. Shpërblimi i drejtuesve të nivelit të lartë dhe personelit përgjegjës për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit të organit të vlerësimit të konformitetit nuk varet nga numri i vlerësimeve të kryera ose nga rezultatet e atyre vlerësimeve.

5. Personeli i një organi të vlerësimit të konformitetit duhet të respektojë sekretin profesional, në lidhje me të gjitha informacionet e marra gjatë kryerjes së detyrave të tyre sipas pikës 3.2, të shtojcës I, dhe shtojcës II, të këtij Rregulli ose çdo dispozitë të legjislacionit kombëtar, që i jep fuqi, përveçse në lidhje me autoritetet kompetente ku kryhen veprimtaritë e tij. Të drejtat e pronësisë mbrohen.

Neni 21

Prezumimi i konformitetit të organit të miratuar

Kur organi i vlerësimit të konformitetit tregon përputhshmërinë e tij me kriteret e përcaktuara në standardet përkatëse të harmonizuara ose pjesët e tyre, referencat e të cilave janë botuar në Fletoren Zyrtare, do të prezumohet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 20 për aq sa



standardet e aplikueshme të harmonizuara i mbulojnë këto kërkesa.

Neni 22

Degët dhe nënkontraktimi nga organet e miratuara

1. Kur një organ i miratuar nënkontraktin detyra specifike të lidhura me vlerësimin e konformitetit ose i drejtohet për ndihmë një dege, ai siguron që nënkontraktori ose dega të përmbushë kërkesat e përcaktuara në nenin 20, të këtij Rregulli, dhe të informojë përkatësisht autoritetin miratues.

2. Organet e miratuara marrin përgjegjësi të plotë për detyrat e kryera nga nënkontraktorët ose degët, kudo që janë krijuar.

3. Aktivitetet mund të nënkontraktohen ose të kryhen nga një degë vetëm me marrëveshje me klientin.

4. Organet e miratuara mbajnë në dispozicion të autoritetit miratues dokumentet përkatëse, në lidhje me vlerësimin e kualifikimeve të nënkontraktorit ose të degës dhe punën e kryer prej tyre, sipas pikës 3.2, të shtojcës I, dhe sipas shtojcës II të këtij Rregulli.

Neni 23

Aplikimi për miratim

1. Organi i vlerësimit të konformitetit duhet të paraqesë një kërkesë për miratim tek autoriteti miratues, në përputhje me të gjitha kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

2. Kërkesa për miratim duhet të shoqërohet me një përshkrim të aktiviteteve të vlerësimit të konformitetit, modulën ose modulet e vlerësimit të konformitetit dhe enën ose enët për të cilat ai organ pretendon se është kompetent, si dhe me një certifikatë akreditimi, lëshuar nga organi kombëtar i akreditimit, që vërteton se organi i vlerësimit të konformitetit përmbush kërkesat e përcaktuara në nenin 20 të këtij Rregulli.

Neni 24

Procedura e miratimit

Autoriteti miratues miraton vetëm organet e vlerësimit të konformitetit që kanë përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 20, të këtij Rregulli, si dhe ato të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 25

Ndryshime në miratim

1. Kur ministri përgjegjës ka dyshime ose informohet se një organ i miratuar nuk i përmbush më kërkesat e miratimit të përcaktuara në nenin 20 të këtij Rregulli, ose nuk përmbush më detyrimet e tij, atëherë ai, sipas rastit dhe në varësi të shkallës së mospërmbushjes së kërkesave ose detyrimeve, pezullon ose anulon miratimin.

2. Në rast pezullimi ose anulimi të miratimit ose kur organi i miratuar ka pushuar veprimtarinë e tij, ministri përgjegjës merr masat e duhura për të siguruar që dosjet t'i kalojnë një organi tjetër të miratuar ose, sipas rastit, të mbahen në dispozicion të ministrit ose strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

Neni 26

Detyrimet operationale të organeve të miratuara

1. Organet e miratuara kryejnë vlerësime të konformitetit, në përputhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit, parashikuar në shtojcën II të këtij Rregulli.

2. Vlerësimet e konformitetit bëhen në mënyrë proporcionale, duke shmangur ngarkesat e panevojshme për operatorët ekonomikë. Organet e vlerësimit të konformitetit kryejnë aktivitetet e tyre duke marrë parasysh madhësinë e një ndërmarrjeje, sektorin në të cilin operon, strukturën e tij, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë së enës në fjalë dhe masën ose natyrën seriale të procesit të prodhimit. Ata respektojnë, gjithsesi, shkallën e saktësisë dhe nivelin e mbrojtjes së kërkuar për përputhshmërinë e enës me këtë Rregull.

3. Kur një organ i miratuar konstaton se kërkesat thelbësore të sigurisë të përcaktuara në shtojcën I, të këtij Rregulli ose standardet përkatëse



të harmonizuara ose specifikimet e tjera teknike nuk janë përmbushur nga një prodhues, ai kërkon që prodhuesi të marrë masa korrigjuese të përshtatshme dhe nuk lëshon certifikatë ose vendim miratimi.

4. Kur, gjatë monitorimit të konformitetit, pas lëshimit të një certifikate, një organ i miratuar konstaton se një enë nuk është më në përputhje me kërkesat, ai kërkon që prodhuesi të marrë masa të duhura korrigjuese dhe të pezullojë ose të tërheqë certifikatën ose vendimin e miratimit, nëse është e nevojshme.

5. Kur nuk merren masa korrigjuese ose kur ato nuk kanë efektin e kërkuar, organi i miratuar kufizon, pezullon ose tërheq certifikatat apo vendimet e miratimit, sipas rastit.

Neni 27

Apelimi kundër vendimeve të organeve të miratuara

Organet e miratuara duhet të kenë të rregulluar procedurën e apelimit ndaj vendimeve të tyre. Organi i miratuar informon autoritetin miratues, në lidhje me çfarëdo apelimi të pranuar dhe mënyrën se si ai është zgjidhur.

Neni 28

Detyrimi i informacionit për organet e miratuara

1. Organet e miratuara njoftojnë autoritetin miratues për sa vijon:

a) çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje të një certifikate ose vendim miratimi;

b) çdo rrethanë që ndikon në fushën ose kushtet e miratimit;

c) çdo kërkesë për informacion që kanë marrë nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, në lidhje me aktivitetet e vlerësimit të konformitetit;

ç) sipas kërkesës për veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit të kryera në fushën e miratimit të tyre dhe çdo veprimtari tjetër të kryer, përfshirë veprimtaritë ndërkufitare dhe nënkontraktimin.

2. Organet e miratuara duhet t'u japin organeve të tjera, të miratuara në përputhje me këtë Rregull, që kryejnë veprimtari të ngjashme për vlerësimin e konformitetit, që mbulojnë të njëjtat enë, informacione përkatëse për çështje që lidhen me

rezultatet negative dhe, me kërkesë, në lidhje me rezultatet pozitive të vlerësimit të konformitetit.

KREU V

MBIKËQYRJA E TREGUT, KONTROLLI I ENËVE QË VENDOSEN NË TREG DHE PROCEDURAT E SIGURISË

Neni 29

Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i enëve që futen në treg

Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i enëve që hyjnë në treg bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 30

Procedurat në lidhje me enët që paraqesin rrezik në nivel kombëtar

1. Kur struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut ka arsye të mjaftueshme për të besuar se një enë e mbuluar nga ky Rregull paraqet rrezik për shëndetin ose sigurinë e personave ose për kafshët shtëpiake ose për pronën, ajo kryen një vlerësim në lidhje me enën përkatëse, që përfshin të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë Rregull. Për këtë qëllim, operatorët ekonomikë përkatës bashkëpunojnë, sipas nevojës me strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut.

2. Nëse gjatë vlerësimit të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut konstaton se ena nuk i plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë Rregull, ajo kërkon menjëherë nga operatori ekonomik përkatës që të ndërmarrë të gjitha masat e duhura korrigjuese për të sjellë enën në përputhje me këto kërkesa, për ta tërhequr enën nga tregu ose për ta kthyer atë, brenda një periudhe të arsyeshme, në përpjesëtim me natyrën e rrezikut, siç mund ta përshkruajnë ata. Këto masa merren në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbikëqyrjen e tregut lidhur me ndalimin e tregtimit dhe masat kufizuese.

3. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut informon në mënyrë të përshtatshme organin e miratuar përkatës.

4. Operatori ekonomik duhet të sigurojë që të marrë të gjitha masat e duhura korrigjuese, në lidhje



me të gjitha enët përkatëse që ai ka vënë në dispozicion në treg.

5. Kur operatori ekonomik përkatës nuk ndërmer veprime të përshtatshme korrigjuese brenda periudhës së përcaktuar, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr të gjitha masat e duhura të përkohshme për të ndaluar ose kufizuar bërjen të disponueshme të enëve në treg, për të tërhequr enën nga tregu ose për ta kthyer atë.

6. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut informon menjëherë organin e miratuar për masat e marra, sipas pikës 5 më sipër.

7. Informacioni i përmendur në pikën 6 të këtij neni përfshin të gjitha detajet në dispozicion, veçanërisht të dhënat e nevojshme për identifikimin e enës që nuk është në përputhje, origjinën e saj, natyrën e mospërputhjes së pretenduar dhe rrezikun e përfshirë, natyrën dhe kohëzgjatjen e masave të marra dhe argumentet e paraqitura nga operatori ekonomik përkatës. Në veçanti, strukturat e mbikëqyrjes së tregut tregojnë nëse mospërputhja është për shkak të arsyeve, si më poshtë:

a) ena nuk përmbush kërkesat në lidhje me shëndetin ose sigurinë e personave, mbrojtjen e kafshëve shtëpiake ose pronës; ose

b) mangësi në standardet e harmonizuara të përmendura në nenin 12, që tregojnë prezumimin e konformitetit.

Neni 31

Enët në përputhje me këtë Rregull që paraqesin rrezik

1. Kur struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, pas vlerësimit të bërë sipas nenit 30, të këtij Rregulli, konstaton që megjithëse ena është në përputhje me këtë Rregull, ajo paraqet rrezik për shëndetin ose sigurinë e personave, për kafshët shtëpiake ose pronën, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar që ena në fjalë, kur të vendoset në treg, nuk e paraqet më atë rrezik, të tërheqë enën nga tregu ose ta kthejë atë brenda një periudhe të arsyeshme, në përpjesëtim me natyrën e rrezikut, siç mund të përshkruhet.

2. Operatori ekonomik sigurohet të ndërmarrë veprime korrigjuese, në lidhje me të gjitha enët në fjalë që ai ka bërë të disponueshme në treg.

Neni 32

Mospërputhja formale

1. Pa rënë ndesh me nenin 31 të këtij Rregulli, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut kërkon që operatori ekonomik përkatës të sjellë enën në përputhje me këtë Rregull, kur konstaton një nga rastet e mëposhtme:

a) Markimi CE është fiksuar në kundërshtim me nenin 16 të këtij Rregulli;

b) Markimi CE nuk është fiksuar;

c) Numri i identifikimit të organit të miratuar, të përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit nuk është vendosur ose është vendosur në kundërshtim me nenin 16 të këtij Rregulli;

ç) Mbishkrimet e përmendura në pikën 1, të shtojcës III, të këtij Rregulli, nuk janë vendosur ose janë vendosur në kundërshtim me nenin 16, të këtij Rregulli, ose pikën 1, të shtojcës III, të këtij Rregulli;

d) Deklarata EU e konformitetit nuk është hartuar;

dh) Deklarata EU e konformitetit nuk është hartuar si duhet;

e) Dokumentacioni teknik nuk është në dispozicion ose nuk është i plotë.

ë) Informacioni i përmendur në nenin 6, pika 10, ose në nenin 8, pika 4, mungon, është i rremë ose i paplotë;

f) Çdo kërkesë tjetër administrative e parashikuar në nenin 6 ose nenin 8 nuk është përmbushur.

2. Kur mospërputhja formale e përmendur në pikën 1 të këtij neni vazhdon, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut duhet të marrë të gjitha masat e duhura për të kufizuar ose ndaluar enën që është vendosur në treg ose të sigurohet që ajo të tërhiqet nga tregu ose të kthehet.

Neni 33

Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e kërkesave të këtij Rregulli nga operatorët ekonomikë trajtohen, sipas legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.



SHTOJCAT

SHTOJCA I
KËRKESAT THELBËSORE TË SIGURISË

1. Materialet

Materialet do të zgjidhen sipas qëllimit të përdorimit të enëve dhe në përputhje me pikat 1.1 deri në 1.4.

1.1 Pjesët nën presion

Materialet e përdorura për prodhimin e pjesëve nën presion të enëve duhet të jenë:

- a) në gjendje për t'u salduar;
- b) duktil dhe të fortë, në mënyrë që një rënie në temperaturën minimale të punës të mos shkaktojë as copëtim, as thyerje për shkak të brishtësisë;
- c) të mos ndikohen negativisht nga vjetrimi.

Për enët e çelikut, materialet duhet të plotësojnë, gjithashtu, kërkesat e përcaktuara në pikën 1.1.1 dhe, për enët prej alumini ose aliazh alumini, ato të përcaktuara në pikën 1.1.2.

Ato shoqërohen nga një fletë inspektimi, siç përcaktohet në shkronjën “i”, të pikës 3.1, të shtojcës III, të këtij Rregulli, të hartuar nga prodhuesi i materialeve.

1.1.1 Enët prej çeliku

Çeliquet cilësore jo të aliazhuara duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) ato duhet të jenë jofluskuese dhe të furnizohen pas trajtimit të normalizimit ose në një gjendje ekuivalente;

b) përmbajtja e karbonit për produkt duhet të jetë më e vogël se 0,25% dhe ajo e squfurit dhe fosforit duhet të jetë secila më e vogël se 0,05%;

c) ato duhet të kenë vetitë mekanike të mëposhtme për produkt:

i. rezistenca maksimale në tërheqje R_m , max duhet të jetë më e vogël se 580 N/mm²;

ii. zgjatja pas thyerjes duhet të jetë:

Nëse pjesët për testimin merren paralelisht me drejtimin e rrotullimit:

trashësia ≥ 3 mm:	A	≥ 22 %,
trashësia < 3 mm:	A80 mm	≥ 17 %,

Nëse pjesët për testimin merren pingul me drejtimin e rrotullimit:

trashësia ≥ 3 mm:	A	≥ 20 %,
trashësia < 3 mm:	A80 mm	≥ 15 %,

iii. energjia mesatare e këputjes së përkuljes KCV për tri teste gjatësore në temperaturën minimale të punës nuk duhet të jetë më e vogël se 35 J/cm². Jo më shumë se një nga tri shifrat mund të jetë më pak se 35 J/cm², me një minimum prej 25 J/cm². Në rastin e çelikeve të destinuara për t'u përdorur për prodhimin e enëve, temperatura minimale e punës e të cilave është më e ulët se – 10°C dhe trashësia e murit të të cilave kalon 5 mm, kjo veti duhet të kontrollohet.

1.1.2 Enët prej alumini

Alumini pa aliazh duhet të ketë një përmbajtje alumini prej të paktën 99,5% dhe lidhjet e përmendura në shkronjën “b”, të nenit 1(1), duhet të shfaqin rezistencë të përshtatshme ndaj

korrozionit ndërkristalor në temperaturën maksimale të punës.

Për më tepër, këto materiale duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) ato duhet të furnizohen në gjendje të pjekur;

b) ato duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme për produkt:

- rezistenca maksimale në tërheqje R_m , max nuk duhet të jetë më shumë 350 N/mm²,

- zgjatja pas thyerjes duhet të jetë:

- $A \geq 16$ % nëse pjesa për testim merret paralel me drejtimin e rrotullimit;

- $A \geq 14$ % nëse pjesa për testim merret pingul me drejtimin e rrotullimit.

Materialet e saldimit



1.2 Materialet e saldimit të përdorura për prodhimin e saldimeve në enë ose të enëve duhet të jenë të përshtatshme dhe të pajtueshme me materialet që do të saldohen.

1.3 Aksesorët që kontribuojnë për fortësinë e enëve

Këta aksesorë (për shembull bulonat dhe dadot) do të jenë prej një materiali të specifikuar në pikën 1.1 ose nga lloje të tjera çeliku, alumini ose një aliazhi, të përshtatshëm alumini, të përputhshëm me materialet e përdorura për prodhimin e pjesëve nën presion.

Materialet e fundit në temperaturën minimale të punës duhet të kenë një zgjatim të përshtatshëm pas thyerjes dhe këputjes së përkuljes.

1.4 Pjesët jo nën presion

Të gjitha pjesët pa presion të enëve të salduara duhet të jenë prej materialesh që janë të përputhshme me atë të përbërësve ku ato janë salduar.

2. Projektimi i enëve

a) Prodhuesi, gjatë projektimit të enës, duhet të përcaktojë përdorimin për të cilin bëhet projektimi dhe të zgjedhë:

- i. temperaturën minimale të punës T_{min} ;
- ii. temperaturën maksimale të punës T_{max} ;
- iii. presionin maksimal të punës PS.

Megjithatë, nëse zgjidhet një temperaturë minimale e punës që tejkalon -10°C , cilësitë e kërkuara të materialeve duhet të plotësohen në -10°C .

b) Prodhuesi do të marrë, gjithashtu, parasysh dispozitat e mëposhtme:

i duhet të jetë e mundur të inspektohet pjesa e brendshme e enëve;

ii duhet të jetë e mundur kullimi i enëve;

iii cilësitë mekanike duhet të mbahen gjatë gjithë periudhës së përdorimit të enës për qëllimin e synuar;

iv. enët, duke pasur parasysh përdorimin e përshkruar të tyre, duhet të mbrohen në mënyrë të përshtatshme kundër korrozionit.

c) Prodhuesi duhet të marrë parasysh faktin se në kushtet e parashikuara të përdorimit:

i. enët nuk do t'u nënshtrohen streseve që mund të dëmtojnë sigurinë e tyre në përdorim;

ii. presioni i brendshëm nuk duhet të kalojë përgjithmonë presionin maksimal të punës PS.

Megjithatë, për momentin mund ta bëjë këtë deri në 10%.

ç) Tegelet rrethore dhe gjatësore do të bëhen duke përdorur saldime me depërtim të plotë ose saldime me efektivitet ekuivalent. Skajet konvekse të ndryshme nga ato gjysmësferike duhet të kenë një cep cilindrik.

2.1 Trashësia e murit

Nëse produkti i PS×V nuk është më shumë se 3 000 bar.L, prodhuesi do të zgjedhë një nga metodat e përshkruara në pikat 2.1.1 dhe 2.1.2 për përcaktimin e trashësisë së murit të enës; nëse produkti i PS×V është më shumë se 3 000 bar.L, ose nëse temperatura maksimale e punës kalon 100°C , kjo trashësi duhet të përcaktohet me metodën e përshkruar në pikën 2.1.1.

Megjithatë, trashësia aktuale e murit të seksionit cilindrik dhe skajeve duhet të jetë jo më pak se 2 mm në rastin e enëve të çelikut dhe jo më pak se 3 mm në rastin e enëve prej alumini ose prej aliazhi alumini.

2.1.1 Metoda e llogaritjes

Trashësia minimale e pjesëve nën presion do të llogaritet duke pasur parasysh intensitetin e sforcimeve dhe dispozitat e mëposhtme:

a) Presioni i llogaritjes që do të merret parasysh nuk duhet të jetë më i vogël se presioni maksimal i punës PS i përzgjedhur;

b) Sforcimi i përgjithshëm i lejueshëm i membranës nuk duhet të kalojë vlerën më të ulët prej $0,6 R_{eT}$ ose $0,3 R_m$. Prodhuesi do të përdorë vlerat minimale R_{eT} dhe R_m të garantuara nga prodhuesi i materialit për të përcaktuar stresin e lejueshëm.

Megjithatë, kur pjesa cilindrike e enës ka një ose më shumë saldime gjatësore të bëra duke përdorur një proces saldimi joautomatik, trashësia e llogaritur, siç përmendet në paragrafin e parë, do të shumëzohet me koeficientin 1,15.

2.1.2 Metoda eksperimentale

Trashësia e murit duhet të përcaktohet në mënyrë që t'u mundësojë enëve t'i rezistojnë në temperaturën e ambientit një presioni të barabartë me të paktën pesë herë presionin maksimal të punës, me një faktor të përhershëm deformimi rrethues prej jo më shumë se 1%.

3. Proceset e prodhimit

Enët do të ndërtohen dhe do t'u nënshtrohen kontroleve të prodhimit në përputhje me pikat 2, 3 ose 4 të shtojcës II.



3.1 Përgatitja e pjesëve përbërëse

Përgatitja e pjesëve përbërëse (për shembull formimi dhe prerja) nuk duhet të shkaktojë defekte në sipërfaqe ose çarje ose ndryshime të karakteristikave mekanike që mund të jenë të dëmshme për sigurinë e enëve.

3.2 Saldimet në pjesët nën presion

Karakteristikat e saldimeve dhe zonave ngjitur duhet të jenë të ngjashme me ato të materialeve të salduara dhe nuk duhet të kenë asnjë sipërfaqe ose defekt të brendshëm që dëmton sigurinë e enëve.

Saldimet duhet të kryhen nga saldatorë ose operatorë të kualifikuar që zotërojnë nivelin e duhur të kompetencës, në përputhje me proceset e miratuara të saldimit. Këto miratime dhe testet e kualifikimit do të kryhen nga organet e miratuara.

Gjithashtu, gjatë prodhimit, prodhuesi duhet të sigurojë cilësi të qëndrueshme saldimit duke kryer teste të duhura përmes përdorimit të procedurave të përshtatshme. Këto teste do të jenë objekt i një raporti.

4. Vënia e enëve në shërbim

Enët duhet të shoqërohen nga udhëzimet e hartuara nga prodhuesi, siç referohet në pikën 2, të shtojcës III, të këtij Rregulli.

SHTOJCA II PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN E KONFORMITETIT

1. Shqyrtimi EU i tipit (Moduli B)

1.1 Shqyrtimi EU i tipit është pjesa e një procedure vlerësimi të konformitetit, përmes së cilës një organ analizon projektimin teknik të një ene dhe verifikon e vërteton se projektimi teknik i enës plotëson kërkesat e këtij Rregulli që janë të zbatueshme mbi të.

1.2 Shqyrtimi EU i tipit do të kryhet në njërën nga mënyrat e mëposhtme në përputhje me nenin 13 të këtij Rregulli:

- vlerësimi i përshtatshmërisë së projektimit teknik të enës nëpërmjet ekzaminimit të dokumentacionit teknik dhe provave mbështetëse të përmendura në pikën 1.3, plus shqyrtimin e një prototipi, përfaqësues të prodhimit të parashikuar, të enës së plotë (lloji i prodhimit);

- vlerësimi i përshtatshmërisë së projektimit teknik të enës nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe provave mbështetëse

të përmendura në pikën 1.3, pa shqyrtimin e një ene prototip (lloji projektues).

1.3 Prodhuesi duhet të depozitojë një kërkesë për shqyrtimin EU të tipit tek një organ i vetëm i zgjedhur prej tij.

Kërkesa duhet të përmbajë:

- a) Emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse kërkesa dorëzohet nga përfaqësuesi i autorizuar, edhe emrin dhe adresën e tij;

- b) Një deklaratë me shkrim se e njëjta kërkesë nuk është depozituar në asnjë organ tjetër;

- c) Dokumentacionin teknik: dokumentacioni teknik do të bëjë të mundur vlerësimin e konformitetit të enës me kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli dhe do të përfshijë një analizë dhe vlerësim të përshtatshëm të rrezikut (rreziqeve).

Dokumentacioni teknik do të specifikojë kërkesat e zbatueshme dhe do të mbulojë, për aq sa është e rëndësishme për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e enës. Dokumentacioni teknik duhet të përmbajë, kudo që është e zbatueshme, të paktën elementet e mëposhtme:

- i. një përshkrim të përgjithshëm të enës;
- ii. projektimin konceptual dhe skicat e prodhimit dhe skemat e komponentëve etj.;
- iii. përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për t'i kuptuar këto skica dhe skema dhe funksionimin e enëve;

- iv. një listë të standardeve të harmonizuara të zbatuara plotësisht ose pjesërisht, referencat e të cilave janë botuar në Fletoren Zyrtare dhe, kur ato standarde të harmonizuara nuk janë zbatuar, përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për të përmbushur kërkesat thelbësore të sigurisë të këtij Rregulli, duke përfshirë një listë të specifikimeve të tjera teknike përkatëse të aplikuara. Në rast të standardeve të harmonizuara pjesërisht të aplikuara, dokumentacioni teknik do të specifikojë pjesët që janë aplikuar;

- v. rezultatet e llogaritjeve të projektimit të bëra, shqyrtimet e kryera etj.;

- vi. raportet e testimit;

- vii. udhëzimet dhe informacionet e sigurisë të përmendura në pikën 2 të shtojcës III;

- viii. një dokument i cili përshkruan:

- materialet e përzgjedhura,
- procesin e saldimit të përzgjedhur,
- kontrollet e përzgjedhura,



- çdo detaj tjetër të lidhura me projektimin e enës;

ç) Kur është e aplikueshme, prototipin e enëve përfaqësuese të prodhimit të parashikuar. Organi mund të kërkojë prototip të mëtejshëm enësh nëse është e nevojshme për kryerjen e programit të testimit;

d) Dëshminë mbështetëse për përshtatshmërinë e zgjidhjes së projektimit teknik. Kjo dëshmi mbështetëse do të përmendë çdo dokument që është përdorur, veçanërisht kur standardet përkatëse të harmonizuara nuk janë zbatuar plotësisht. Dëshmia mbështetëse përfshin, kur është e nevojshme, rezultatet e testeve të kryera në përputhje me specifikimet e tjera teknike përkatëse nga laboratorit përkatës i prodhuesit ose nga një laborator tjetër testimi në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij.

Kur shqyrtohet një enë prototip, duhet të përfshihet edhe dokumentacioni teknik:

- certifikatat në lidhje me kualifikimin e përshtatshëm të operacioneve të saldimit dhe të saldatorëve ose operatorëve të saldimit;

- fletën e inspektimit për materialet e përdorura për prodhimin e pjesëve dhe komponentëve që kontribuojnë për fuqinë e enës;

- një raport mbi ekzaminimet dhe testet e kryera ose një përshkrim të kontrolleve të propozuara.

1.4. Organi duhet:

Për enën:

1.4.1 të shqyrtojë dokumentacionin teknik dhe provat mbështetëse për të vlerësuar përshtatshmërinë e projektimit teknik të enës

Për enën/ët prototip:

1.4.2 të verifikojë që ena/ët prototip është/janë prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik, se mund të përdoret në mënyrë të sigurt në kushtet e synuara të punës dhe të identifikojë elementet që janë projektuar në përputhje me dispozitat e zbatueshme të standardeve të harmonizuara përkatëse, si dhe elementet që janë projektuar në përputhje me specifikimet e tjera teknike përkatëse;

1.4.3 të kryejë shqyrtimet dhe testet e duhura ose të sigurojë kryerjen e tyre, për të kontrolluar nëse, kur prodhuesi ka zgjedhur të zbatojë zgjidhjet në standardet përkatëse të harmonizuara, ato janë zbatuar në mënyrë korrekte;

1.4.4 të kryejë shqyrtimet dhe testet e duhura, ose të sigurojë kryerjen e tyre, për të kontrolluar

nëse, kur zgjidhjet në standardet përkatëse të harmonizuara nuk janë zbatuar, zgjidhjet e miratuara nga prodhuesi që zbatojnë specifikime të tjera teknike përkatëse plotësojnë kërkesat e rëndësishme përkatëse të sigurisë të këtij Rregulli;

1.4.5 të bjerë dakord me prodhuesin për një vend ku do të kryhen shqyrtimet dhe testet.

1.5 Organi duhet të hartojë një raport vlerësimi ku regjistrohen aktivitetet e ndërmarra në përputhje me pikën 1.4 dhe rezultatet e tyre. Pa cenuar detyrimet e tij kundrejt autoritetit miratues, organi do të botojë përmbajtjen e atij raporti, plotësisht ose pjesërisht, vetëm me marrëveshjen e prodhuesit

1.6 Kur lloji plotëson kërkesat e këtij Rregulli, organi do t'i lëshojë prodhuesit një certifikatë shqyrtimi EU të tipit. Ajo certifikatë duhet të përmbajë emrin dhe adresën e prodhuesit, përfundimet e shqyrtimit, kushtet (nëse ka) për vlefshmërinë e saj dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e llojit të miratuar. Certifikata e shqyrtimit EU të tipit mund të ketë një ose më shumë shtojca të bashkëlidhura.

Certifikata e shqyrtimit EU të tipit dhe shtojcat e saj do të përmbajnë të gjithë informacionin përkatës për të lejuar vlerësimin e konformitetit të enëve të prodhuara me tipin e shqyrtuar dhe për të lejuar kontrollin gjatë shërbimit. Ai, gjithashtu, duhet të tregojë çdo kusht të cilit mund t'i nënshtrohet lëshimi i tij dhe të shoqërohet me përshkrimet dhe skicat e nevojshme për identifikimin e llojit të miratuar.

Kur lloji nuk i plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli, organi do të refuzojë të lëshojë një certifikatë shqyrtimi EU të tipit dhe do të informojë aplikantin në përputhje me rrethanat, duke dhënë arsye të hollësishme për refuzimin e kërkesës.

1.7 Organi duhet të jetë i informuar për çdo ndryshim në gjendjen përgjithësisht të njohur të teknologjisë, i cili tregon se lloji i miratuar mund të mos përputhet më me kërkesat e zbatueshme, sipas këtij Rregulli dhe do të përcaktojë nëse ndryshime të tilla kërkojnë hetim të mëtejshëm. Nëse po, organi duhet të informojë prodhuesin në përputhje me rrethanat.

Prodhuesi informon organin, i cili mban dokumentacionin teknik në lidhje me certifikatën e shqyrtimit EU të tipit, për të gjitha modifikimet e miratuara të tipit që mund të ndikojnë në



konformitetin e enës me kërkesat thelbësore të sigurisë të këtij Rregulli ose kushtet për vlefshmërinë e këtij të fundit. Këto modifikime do të kërkojnë miratim shtesë në trajtën e një shtesë në certifikatën origjinale të shqyrtimit EU të tipit.

1.8 Çdo organ do të informojë autoritetin miratues në lidhje me certifikatat e shqyrtimit EU të tipit dhe/ose çdo shtesë që ai ka lëshuar ose tërhequr dhe, në mënyrë periodike ose sipas kërkesës, do t'i vërë në dispozicion autoritetit përkatës listën e këtyre certifikatave dhe/ose çdo shtesë lidhur me refuzimet, pezullimet ose kufizime të tjera të ndryshme.

Çdo organ do të informojë organet e tjera të miratuara në lidhje me certifikatat e shqyrtimit EU të tipit dhe/ose çdo shtesë që ai ka refuzuar, revokuar, pezulluar ose kufizuar në ndonjë mënyrë tjetër, dhe, me kërkesë, në lidhje me këto certifikata dhe/ose shtesa të cilat ai ka lëshuar.

Autoriteti miratues, si dhe organet e tjera të miratuara, me kërkesë, mund të marrin një kopje të certifikatave të shqyrtimit EU të tipit dhe/ose shtesave në to. Pas dorëzimit të kërkesës, autoriteti miratues mund të marrë një kopje të dokumentacionit teknik dhe të rezultateve të shqyrtimeve të kryera nga organi. Organi do të mbajë një kopje të certifikatës së shqyrtimit EU të tipit, shtojcat dhe shtesat në të, si dhe dosjen teknike duke përfshirë dokumentacionin e paraqitur nga prodhuesi, deri në skadimin e vlefshmërisë së asaj certifikate.

1.9 Prodhuesi do të mbajë një kopje të certifikatës së shqyrtimit EU të tipit, shtojcat dhe shtesat e saj së bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare, për 10 vjet pasi të jetë hedhur në treg ena.

1.10 Përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit mund të paraqesë kërkesën e përmendur në pikën 1.3 dhe të përmbushë detyrimet e përcaktuara në pikat 1.7 dhe 1.9, me kusht që ato të specifikohen në mandat.

2. Konformiteti me llojin në bazë të kontrollit të brendshëm të prodhimit, plus testimin e mbikëqyrur të enës (Moduli C1)

2.1 Konformiteti me llojin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit, plus testimin e mbikëqyrur të enës, është pjesë e një procedure vlerësimi të konformitetit ku prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2.2, 2.3 dhe 2.4 dhe siguron dhe deklaron nën përgjegjësinë e tij të

vetme që enët në fjalë janë në konformitet me llojin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit dhe plotësojnë kërkesat e këtij Rregulli që zbatohen për to.

2.2 Prodhimi

Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë konformitetin e enëve të prodhuara me llojin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit me kërkesat e këtij Rregulli që zbatohen mbi to.

Përpara fillimit të prodhimit, prodhuesi duhet t'i sigurojë një organi të përzgjedhur prej tij të gjithë informacionin e nevojshëm dhe, në veçanti:

a) Dokumentacioni teknik, i cili duhet të përfshijë gjithashtu:

- certifikatat në lidhje me kualifikimin e përshtatshëm të operacioneve të saldimit dhe të saldatorëve ose operatorëve të saldimit;

- fletën e inspektimit për materialet e përdorura për prodhimin e pjesëve dhe komponentëve që kontribuojnë për fuqinë e enës;

- një raport mbi shqyrtimet dhe analizat e kryera;

b) Dokumentin e inspektimit, i cili përshkruan shqyrtimet dhe testet e duhura që do të kryhen gjatë prodhimit, së bashku me procedurat në lidhje me të dhe shpeshësinë me të cilën do të kryhen ato;

c) Certifikatën e shqyrtimit EU të tipit.

2.3 Kontrollat e enëve

2.3.1 Për çdo enë individuale të prodhuar, organi i miratuar do të kryejë shqyrtimet dhe testet e duhura për të verifikuar konformitetin e enës me llojin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit dhe me kërkesat përkatëse të këtij Rregulli, në përputhje me pikat më poshtë.

a) Prodhuesi do të paraqesë enët e tij në formën e grupeve uniforme dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që procesi i prodhimit të sigurojë uniformitetin e secilit grup të prodhuar.

b) Kur shqyrtohet një grup, organi duhet të sigurojë që enët të jenë prodhuar dhe kontrolluar, në përputhje me dokumentacionin teknik dhe kryen një provë hidrostatike ose një provë pneumatike me efekt ekuivalent për secilën enë në grup në një presion Ph të barabartë me 1,5 herë presionin e projektuar të enës për të kontrolluar forcën e saj. Testi pneumatik do t'u nënshtrohet



pranimi të procedurave të sigurisë së testimit nga shteti ku kryhet testi.

c) Për më tepër, organi do të kryejë teste mbi enë të caktuara të marra si enë përfaqësuese të prodhimit ose mbi një enë të përzgjedhur nga prodhuesit, për të shqyrtuar cilësinë e saldimit. Testimet do të kryhen në saldimet gjatësore. Megjithatë, kur përdoren teknika të ndryshme saldimi për saldimet gjatësore dhe rrethore, testet duhet të përsëriten edhe mbi saldimet rrethore.

ç) Për enët që i nënshtrohen metodës eksperimentale të përmendur në pikën 2.1.2 të shtojcës I, këto teste mbi enët e testimit do të zëvendësohen nga një test hidrostatik mbi pesë enë të marra në mënyrë të rastësishme nga secila grup për të kontrolluar nëse ato janë në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë të përcaktuara në pikën 2.1.2 të shtojcës I.

d) Në rastin e grupeve të pranuar, organi do të vendosë numrin e tij të identifikimit ose do të marrë masa që ai numër të vendoset në secilën enë dhe do të hartojë një certifikatë konformiteti me shkrim, në lidhje me testet e kryera. Të gjitha enët në grup mund të vendosen në treg, përveç atyre që nuk i janë nënshtruar me sukses një testi hidrostatik ose një testi pneumatik.

dh) Nëse një grup refuzohet, organi do të marrë masat e duhura për të parandaluar vendosjen në treg të asaj serie. Në rast të refuzimit të shpeshtë të grupeve, organi mund të pezullojë verifikimin statistikor.

e) Prodhuesi duhet të jetë në gjendje të furnizojë me kërkesën e autoriteteve përkatëse certifikatat e konformitetit të organit të përmendura në shkronjën “d”.

2.3.2 Organi do t'i japë autoritetit miratues dhe, sipas kërkesës, organeve të tjera të miratuara, një kopje të raportit të inspektimit të lëshuar prej tij.

2.3.3 Prodhuesi, nën përgjegjësinë e organit, do të vendosë numrin e identifikimit të organit të miratuar gjatë procesit të prodhimit.

2.4 Markimi CE dhe deklarata EU e Konformitetit

2.4.1 Prodhuesi do të vendosë markimin CE në çdo enë individuale që është në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli.

2.4.2 Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë EU të konformitetit për çdo model ene dhe ta vërë atë në dispozicion të autoriteteve

kombëtare për 10 vjet, pasi ena të jetë hedhur në treg. Deklarata EU e konformitetit do të identifikojë modelin e enës për të cilën është hartuar.

2.4.3 Një kopje e deklaratës EU të konformitetit do t'u vihet në dispozicion autoriteteve përkatëse pas dorëzimit të kërkesës.

2.5 Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 2.4 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të specifikohen në mandat.

3. Konformiteti me llojin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit, plus kontrollet e mbikëqyrura të enëve (Moduli C2)

3.1. Konformiteti me llojin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit, plus kontrollet e mbikëqyrura të enëve në intervale të rastësishme, është pjesë e një procedure të vlerësimit të konformitetit, ku prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 3.2, 3.3 dhe 3.4, dhe siguron e deklaron me përgjegjësinë e tij të vetme që enët në fjalë janë në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit dhe plotësojnë kërkesat e këtij Rregulli që zbatohen mbi ta.

3.2 Prodhuesi

3.2.1 Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë konformitetin e enëve të prodhuara me llojin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit dhe me kërkesat e këtij Rregulli që zbatohen mbi to.

3.2.2 Përpara fillimit të prodhimit, prodhuesi duhet t'i dorëzojë një organi të përzgjedhur prej tij të gjithë informacionin e nevojshëm dhe në veçanti:

a) dokumentacioni teknik, i cili duhet të përfshijë, gjithashtu:

- certifikatat në lidhje me kualifikimin e përshtatshëm të operacioneve të saldimit dhe të saldatorëve ose operatorëve të saldimit;

- fletën e inspektimit për materialet e përdorura për prodhimin e pjesëve dhe komponentëve që kontribuojnë për fuqinë e enës;

- një raport mbi shqyrtimet dhe analizat e kryera;

b) certifikatën e shqyrtimit EU të tipit;

c) një dokument që përshkruan proceset e prodhimit dhe të gjitha masat e paracaktuara



sistematike të marra për të siguruar konformitetin e enës me llojin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit;

Organi, përpara datës kur fillon çdo prodhim, i shqyrton ato dokumente për të vërtetuar konformitetin e tyre me certifikatën e shqyrtimit EU të tipit.

3.2.3 Dokumenti i përmendur në shkronjën “c”, të pikës 3.2.2, do të përfshijë:

a) një përshkrim të mjeteve të prodhimit dhe kontrollit të përshtatshëm për ndërtimin e enëve;

b) një dokument inspektimi që përshkruan shqyrtimet dhe testet e duhura që do të kryhen gjatë prodhimit, së bashku me procedurat në lidhje me to dhe shpeshësinë me të cilën ato do të kryhen;

c) një angazhim për të kryer shqyrtimet dhe testet, në përputhje me dokumentin e inspektimit dhe për të kryer një test hidrostatik ose, në varësi të marrëveshjes së shtetit shqiptar, një test pneumatik të kryer në çdo enë të prodhuar me një presion testimi të barabartë me 1,5 herë presionin e projektimit; këto shqyrtime dhe teste do të kryhen nën përgjegjësinë e personelit të kualifikuar që është i pavarur nga personeli i prodhimit dhe do të jenë objekt i një raporti;

ç) adresat e vendeve të prodhimit dhe të magazinimit dhe datën kur do të fillojë prodhimi.

3.3 Kontrollat e enëve

Organi i miratuar do të kryejë kontrolle të enëve ose do të sigurojë kryerjen e tyre në mostra rastësore në intervale të rastësishme të përcaktuara nga organi i miratuar, me qëllim që të verifikohet cilësia e kontrolleve të brendshme në enë, duke marrë parasysh, ndër të tjera, kompleksitetin teknologjik të enëve dhe sasinë e prodhimit. Një kampion i përshtatshëm i enëve përfundimtare, i marrë në vend nga organi i miratuar përpara hedhjes në treg, do të shqyrtohet dhe do të kryhen teste të përshtatshme, siç identifikohen nga pjesët përkatëse të standardeve të harmonizuara dhe/ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikimet e tjera teknike përkatëse, për të kontrolluar konformitetin e enës me tipin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit dhe me kërkesat përkatëse të këtij Rregulli.

Organi i miratuar siguron gjithashtu që prodhuesi të kontrollojë enët e prodhuara në seri në përputhje me shkronjën “c”, të pikës 3.2.3.

Kur një kampion nuk përputhet me nivelin e pranueshëm të cilësisë, organi i miratuar merr masat e duhura.

Procedura e marrjes së mostrave të pranimit që do të zbatohet synon të përcaktojë nëse procesi i prodhimit të enës funksionon brenda kufijve të pranueshëm, me synimin për të siguruar konformitetin e enës.

Organi i miratuar do t'i japë autoritetit miratues dhe, sipas kërkesës, organeve të tjera, një kopje të raportit të inspektimit të lëshuar prej tij.

Prodhuesi, nën përgjegjësinë e organit të miratuar, vendos numrin e identifikimit të organit të miratuar gjatë procesit të prodhimit.

3.4 Markimi CE dhe deklarata EU e konformitetit

3.4.1 Prodhuesi do të vendosë markimin CE në çdo enë individuale, që është në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli.

3.4.2 Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit EU për çdo model ene dhe ta vërë atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet, pasi ena të jetë hedhur në treg. Deklarata EU e konformitetit do të identifikojë modelin e enës për të cilën është hartuar.

3.4.3 Një kopje e deklaratës EU të konformitetit do t'u vihet në dispozicion autoriteteve përkatëse pas dorëzimit të kërkesës.

3.5 Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 3.4 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të specifikohen në mandat.

4. Konformiteti me llojin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit (Moduli C)

4.1 Konformiteti me llojin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit është pjesë e një procedure të vlerësimit të konformitetit ku prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 4.2 dhe 4.3 dhe siguron dhe deklaron me përgjegjësinë e tij të vetme që enët në fjalë janë në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit dhe plotësojnë kërkesat e këtij Rregulli që zbatohen mbi to.

4.2 Prodhuesi

Prodhuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që procesi i prodhimit dhe



monitorimi i tij të sigurojnë konformitetin e enëve të prodhuara me llojin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit dhe me kërkesat e këtij Rregulli që zbatohen mbi to.

Përpara fillimit të prodhimit, prodhuesi duhet t'i dorëzojë një organi të përzgjedhur prej tij të gjithë informacionin e nevojshëm dhe, në veçanti:

a) certifikatat në lidhje me kualifikimin e përshtatshëm të operacioneve të saldimit dhe të saldatorëve ose operatorëve të saldimit;

b) fletën e inspektimit për materialet e përdorura për prodhimin e pjesëve dhe komponentëve që kontribuojnë në fuqinë e enës;

c) një raport mbi shqyrtimet dhe testet e kryera;

ç) një dokument që përshkruan proceset e prodhimit dhe të gjitha masat e paracaktuara sistematike të marra për të siguruar konformitetin e enës me llojin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit.

Ky dokument duhet të përfshijë:

i. një përshkrim të mjeteve të prodhimit dhe kontrollit të përshtatshëm për ndërtimin e enëve;

ii një dokument inspektimi që përshkruan shqyrtimet dhe testet e duhura që do të kryhen gjatë prodhimit, së bashku me procedurat, në lidhje me to dhe shpeshësinë me të cilën ato do të kryhen;

iii një angazhim për të kryer shqyrtimet dhe testet në përputhje me dokumentin e inspektimit dhe për të kryer një test hidrostatik ose, në varësi të marrëveshjes së shtetit shqiptar, një test pneumatik të kryer në çdo enë të prodhuar me një presion testimi të barabartë me 1,5 herë presionin e projektimit; këto shqyrtime dhe teste do të kryhen nën përgjegjësinë e personelit të kualifikuar që është i pavarur nga personeli i prodhimit dhe do të jenë objekt i një raporti;

iv. adresat e vendeve të prodhimit dhe magazinimit dhe datën kur do të fillojë prodhimi.

Organi i miratuar, përpara datës së fillimit të çdo prodhimi, i shqyrton ato dokumente për të vërtetuar konformitetin e tyre me certifikatën e shqyrtimit EU të tipit.

4.3 Markimi CE dhe deklarata EU e konformitetit

4.3.1 Prodhuesi do të vendosë markimin CE në çdo enë individuale, që është në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e shqyrtimit EU të tipit dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij Rregulli.

4.3.2 Prodhuesi duhet të hartojë me shkrim një deklaratë të konformitetit EU për çdo model ene dhe ta vërë atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare, për 10 vjet pasi ena të jetë hedhur në treg. Deklarata EU e konformitetit do të identifikojë modelin e enës për të cilën është hartuar.

4.3.3 Një kopje e deklaratës EU të konformitetit do t'u vihet në dispozicion autoriteteve përkatëse pas dorëzimit të kërkesës përkatëse.

4.4 Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 3.4 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të specifikohen në mandat.

SHTOJCA III

MBISHKRIMET, UDHËZIMET, PËRKUFIZIMET DHE SIMBOLET

1. Markimi CE dhe mbishkrimet

1.1 Enët, në të cilat produkti i PS×V i kalon 50 bar.L duhet të kenë markimin CE të parashikuar në shtojcën II, të këtij Rregulli (EC) nr. 765/2008, dhe dy shifrat e fundit të vitit kur është vendosur markimi CE.

1.2 Enët ose tabelat e tyre të të dhënave duhet të kenë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) presionin maksimal të punës (PS në bar);
- b) temperaturën maksimale të punës (T_{max} në °C);
- c) temperaturën minimale të punës (T_{min} në °C);
- ç) kapacitetin e enës (V inL);
- d) emrin, emrin tregtar të regjistruar ose markën e regjistruar tregtare dhe adresën e prodhuesit;
- dh) llojin dhe identifikimin e serisë ose grupit të enës.

1.3 Kur përdoret tabela e të dhënave, ajo duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të mos mund të ripërdoret dhe të përfshijë një hapësirë bosh për të mundësuar dhënien e informacioneve të tjera.

2. Udhëzimet dhe informacion mbi sigurinë.

Udhëzimet duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

- a) informacionin e kërkuar, sipas pikës 1.2 me përjashtim të identifikimit të serisë ose të grupit të enës;
- b) përdorimin e synuar të enës;



c) kërkesat e mirëmbajtjes dhe të instalimit për sigurinë e enës.

3. Përkufizime dhe simbole

3.1 Përkufizime

a) Presioni i projektimit “P” është presioni matës i zgjedhur nga prodhuesi dhe përdoret për të përcaktuar trashësinë e pjesëve nën presion të enës.

b) Presioni maksimal i punës “PS” është presioni maksimal matës që mund të ushtrohet në kushte normale të përdorimit të enës.

c) Temperatura minimale e punës “T_{min}” është temperatura më e ulët e stabilizuar që muri i enës mund të arrijë në kushte normale përdorimi.

ç) Temperatura maksimale e punës “T_{max}” është temperatura më e lartë e stabilizuar që muri i enës mund të arrijë në kushte normale përdorimi.

d) Forca e rendimentit “ReT” është vlera në temperaturën maksimale të punës T_{max} e cilës prej sa vijon:

i. pika e sipërme e rendimentit “ReH”, për një material me një pikë rendimenti më të ulët dhe të lartë;

ii. 0,2 % e provës së fuqisë R_{p0,2};

iii. 1,0 % e provës së fuqisë R_{p1,0} në rastin e aluminit pa aliazh.

dh) Familjet e enëve:

Enët bëjnë pjesë në të njëjtën familje nëse ndryshojnë nga prototipi vetëm në diametër, me

kusht që kërkesat e lejuara të përmendura në pikat 2.1.1 dhe 2.1.2, të shtojcës I, të përmbushen dhe/ose në gjatësinë e pjesës cilindrike të tyre brenda kufijve të mëposhtëm:

i. kur një prototip ka një ose më shumë unaza guaskë përveç skajeve, variantet duhet të kenë të paktën një unazë predhë;

ii. kur një prototip ka vetëm dy skaje të prera, variantet nuk do të kenë unaza guaska.

Ndryshimet në gjatësi që shkaktojnë modifikimin e hapjeve dhe/ose depërtimeve duhet të tregohen në skicë për secilin variant.

e) një grup enësh përbëhet nga maksimumi 3 000 enë të modelit të të njëjtut lloj.

ë) brenda kuptimit të këtij Rregulli ekziston prodhim seri nëse më shumë se një enë e të njëjtut lloj prodhohet gjatë një periudhe të caktuar nga një proces i vazhdueshëm prodhimi, në përputhje me një dizajn të përbashkët dhe duke përdorur të njëjtat procese prodhimi.

f) Fletë inspektimi: dokument me të cilin prodhuesi i materialeve vërteton se produktet e dorëzuara plotësojnë kërkesat e porosisë dhe ku ai paraqet rezultatet e testit rutinë të inspektimit në fabrikë, në veçanti përbërjen kimike dhe karakteristikat mekanike, të kryera mbi produkte të bëra nga i njëjti proces prodhimi si furnizimi, por jo domosdoshmërisht mbi produktet e furnizuara.

3.2 Simbolet

A	Zgjatim pas thyerjes ($L_0 = 5,65\sqrt{S_0}$)	%
A _{80 mm}	Zgjatim pas thyerjes ($L_0 = 80 \text{ mm}$)	%
KCV	Energjia e këputjes së përkuljes	J/cm ²
P	Presioni i projektimit	Bar
PS	Presioni maksimal i punës	Bar
P _h	Presioni i provës hidrostatike ose pneumatike	Bar
R _{p0,2}	0,2 % rezistencë	N/mm ²
ReT	Temperatura forca e rendimentit në temperaturën maksimale të punës	N/mm ²
ReH	Pika e sipërme e rendimentit	N/mm ²
R _m	Forca në tërheqje	N/mm ²
R _{m, max}	Rezistencë maksimale në tërheqje	N/mm ²
R _{p1,0}	1,0 % rezistencë	N/mm ²
T _{max}	Temperatura maksimale e punës	°C
T _{min}	Temperatura minimale e punës	°C
V	Kapaciteti i enës	L



SHTOJCA IV
DEKLARATA EU E KONFORMITETIT² (NR. XXXX)²

1. Ena/modeli i enës (produkti, lloji, grupi ose numri i serisë):
2. Emri dhe adresa e prodhuesit dhe, sipas rastit, përfaqësuesit të tij të autorizuar:
3. Kjo deklaratë konformiteti lëshohet nën përgjegjësinë vetëm të prodhuesit.
4. Objekti i deklaratës (identifikimi i enës që lejon gjurmueshmërinë; kur është e nevojshme për identifikimin e enës, ai mund të përfshijë edhe një imazh):
5. Objekti i deklaratës së përshkruar më sipër është në përputhje me legjislacionin përkatës harmonizues të Bashkimit:
6. Referencat për standardet përkatëse të harmonizuara të përdorura ose referenca për specifikimet e tjera teknike, në lidhje me të cilat deklarohet konformiteti:
7. Organi ... (emri, numri) ka kryer ... (përshkrimin e ndërhyrjes) dhe ka lëshuar certifikatën:
8. Informacion shtesë:
9. Nënshkruar për dhe në emër të:
(vendi dhe data e lëshimit): (emri, funksioni)(nënshkrimi):

LISTA E STANDARDEVE TE HARMONIZUARA
DIREKTIVA – 2014/29/EU – ENËT E THJESHTA NËN PRESION

Nr.	Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar (dhe dokumenti i referencës)	Titulli i standardit në shqip	Viti i adoptimit si SSH	Mënyra e adoptimit (me faqe të parë FP ose me përkthim të plotë PP)
1	EN ISO 9606-1:2017 Qualification testing of welders - Fusion welding - Part 1: Steels (ISO 9606-1:2012 including Cor 1:2012 and Cor 2:2013)	SSH EN ISO 9606-1:2017 Prova kualifikimi për saldatorët - Saldimi me shkrije – Pjesa 1: Çeliqet ISO 9606-1:2012 përfshirë Kor 1:2012 dhe Kor 2:2013)	2018	FP
2	EN 10207:2017 Steels for simple pressure vessels - Technical delivery requirements for plates, strips and bars	S SH EN 10207:2005 Çelique për enë të thjeshta nën presion - Kushtet teknike të furnizimit të fletëve, shiritave dhe shufrave prej çelikut	2018	FP
3	EN ISO 15614-1:2017 Specification and qualification of welding procedures for metallic materials - Welding procedure test - Part 1: Arc and gas welding of steels and arc welding of nickel and nickel alloys (ISO 15614-1:2004)	S SH EN ISO 15614-1:2017 Specifikim dhe kualifikim i procedurave të saldimit për materialet metalike – Prova e procedurës së saldimit – Pjesa 1: Saldimi me hark dhe me gaz i çeliqueve dhe saldimi me hark nikeli dhe i lidhjeve të nikelit (ISO 15614-1:2017, version i korrigtuar 2017-10-01)	2020	FP
	EN ISO 15614-1:2017/A1:2019	SSH EN ISO 15614-1:2017/A1:2019	2020	FP

²Është opsionale për prodhuesin që t'i caktojë ose jo një numër deklaratës së konformitetit.



4	EN ISO 15614-2:2005 Specification and qualification of welding procedures for metallic materials - Welding procedure test - Part 2: Arc welding of aluminium and its alloys (ISO 15614-2:2005)	S SH EN ISO 15614-2:2005 Specifikimi dhe kualifikimi i procedurave të saldimit për materiale metalike - Prova e kualifikimit të procedurës së saldimit – Pjesa 2: Saldimi me hark i aluminit dhe lidhjeve të aluminit	2007	FP
	EN ISO 15614-2:2005/AC:2009	S SH EN ISO 15614-2:2005/AC:2009	2011	FP

UDHËZIM**Nr. 31 datë 15.11.2022**

**PËR PROCEDURAT PËR KODIFIKIMIN
E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË
OFRUARA NGA INSTITUCIONET E
ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 9, të vendimit nr. 310, datë 11.5.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Përcaktimin e Kodit të Programeve të Studimit, sipas elementeve të mëposhtme:

a) Përcaktimi i nivelit të programit të studimit, sipas nivelit të përcaktuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimit;

b) Kohëzgjatja e programit të studimit;

c) Lloji i programit të studimit;

d) Fusha e detajuar në të cilën bën pjesë programi i studimit;

e) Gjuha e programit të studimit.

2. Për programet ekzistuese të studimit, institucionet e arsimit të lartë (në vijim “IAL”), duhet të dërgojnë zyrtarisht në ministrinë përgjegjëse për arsimin, propozimet e tyre të argumentuara lidhur me kodet që duhet të përmbajnë të gjitha programet që ofrojnë, të grupuara sipas njësive kryesore të IAL-së, shoqëruar me planet e tyre mësimore, si dhe të dhënat për aktin e hapjes dhe/ose akreditimit të programit të studimit (nëse ka).

3. Vlerësimi i propozimeve të IAL-së kryhet nga Komisioni i Përkohshëm (në vijim “Komisioni”), i përbërë nga 3 (tre) ekspertë, sipas fushës, të përzgjedhur nga lista e ekspertëve të jashtëm të miratuar nga Bordi i Akreditimit. Këto Komisione ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Komisioni, vlerëson propozimet e IAL-ve, sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit KSNA 2011 (ISCED 2011) dhe Fushat e Arsimit dhe Trajnimit të KSNA-së (KSNA-F 2013) dhe legjislacionit në fuqi për kodifikimin, brenda 45 ditëve nga përcjellja e dokumentacionit nga ministria përgjegjëse për arsimin.

5. Komisioni, pas vlerësimit, harton raportin me vlerësimin përkatës dhe e depoziton në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Në raportin e vlerësimit Komisioni i propozon ministrit konfirmimin e Kodit për Programin e Studimit ose jep rekomandim lidhur me atë program studimi.

6. Në rast se Komisioni gjatë vlerësimit konstaton që propozimi i IAL-së nuk është i plotë, ministria përgjegjëse për arsimin njofton zyrtarisht IAL-në mbi mangësitë e konstatuara. IAL dërgon plotësimet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit.

7. Në rast se Komisioni gjatë vlerësimit konstaton që propozimi i IAL-së është në përputhje me përcaktimet ligjore mbi kodifikimin e programit të studimit, ministri përgjegjës për arsimin konfirmon kodin për programin përkatës, duke njoftuar IAL-në dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore me shkresë zyrtare.

8. IAL-të, në aplikimin për hapjen e programeve të reja dhe/ose të riorganizuara të studimit në masën mbi 20%, duhet të përfshijnë dhe propozimin për Kodin e Programit.



9. Ministria përgjegjëse për arsimin vlerëson propozimin e IAL-së, në funksion të procedurave për hapjen dhe/ose riorganizimin e programit të studimit, të përcaktuara në udhëzimin përkatës.

10. Kodi i Programit të Studimit përfshihet në aktin e hapjes dhe/ose të riorganizimit të programit të studimit.

11. Kodi, për secilin program studimi, regjistrohet në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor.

12. Për programet ekzistuese të studimit, institucionet e arsimit të lartë duhet të dërgojnë zyrtarisht në ministrinë përgjegjëse për arsimin, propozimet e tyre brenda muajit mars 2023.

13. Kundër vendimit të Komisionit mund të bëhet ankim nga IAL-ja, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila ia përcjell për rishikim komisionit përkatës. Komisioni, brenda 15 ditëve, pas rishqyrtimit të ankimit, merr vendimin përfundimtar.

14. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

URDHËR
Nr. 305, datë 15.11.2022

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; neni 21, shkronja “a”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si edhe të nenit 30, pika 1, germa “a”, të rregullores, “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, për shkak të mungesës në punë për arsye objektive, të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së përfaqësimit të institucionit në marrëdhëniet me palët e treta, znj. Laerta Rooze, Sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

2. Delegimin e kompetencës së mësipërme për periudhën 23.11.2022–25.11.2022.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, znj. Laerta Rooze.

4. Znj. Laerta Rooze nuk mund të nëndelegojë këtë kompetencë.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Albana Shtylla

URDHËR
Nr. 779, datë 10.11.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Kulturës, zëvendësministrit të Ministrisë së Kulturës, znj. Meri Kumbe, nga data 11.11.2022 deri në datën 13.11.2022.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Kulturës, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) trajton dhe nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Kulturës dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit;



b) ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Kulturës, si dhe të institucioneve të varësisë së Ministrisë së Kulturës;

c) bën ndarjen dhe mbikëqyr realizimin e detyrave nga nëpunësit e Ministrisë së Kulturës, në funksion të drejtimit dhe të administrimit të përditshëm të veprimtarisë së Ministrisë së Kulturës.

3. Në ushtrimin e kompetencave, sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës ose personi që ushtron detyrat e tij, në rast mungese. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Kulturës znj. Meri Kumbe.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti

URDHËR
Nr. 780, datë 10.11.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2020, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të germës “c”, të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr.43/2016, “Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Znj. Meri Kumbe, me detyrë zëvendësministre e Ministrisë së Kulturës, të nënshkruajë në emër dhe për llogari të Ministrisë së Kulturës në datë, 13.11.2022, Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës dhe Rinisë të Emirateve të Bashkuara Arabe mbi Bashkëpunimin në Fushën e Kulturës.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Kulturës znj. Meri Kumbe.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë